



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 30/9_prot.

Tiranë, më 12.02.2020

V E N D I M

Nr. 16, datë 12.02.2020

**MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË LIGJSHMËRISË SË VEPRIMIT
ADMINISTRATIV TË LËVIZJES NË DETYRË, TË NËPUNËSES**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dokumentar të mbledhur për verifikimin e informacionit që përmbante kërkesa e nëpunëses së Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), *****,

VËREJ :

Punonjësja ***** është nëpunëse civile, e konfirmuar me aktin nr.1198/17, datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, në pozicionin “Specialiste (me grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve, Departamenti i Mikrobiologjisë”, në institucionin e ISUV.

Punonjësja në fjalë ka vazhduar të kryejë këtë detyrë deri në momentin kur, me urdhrin nr.135, datë 12.12.2019, titullari i institucionit ka urdhëruar lëvizjen paralele të saj, nga pozicioni “Specialist (me grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve Shtazore, Departamenti i Mikrobiologjisë”, në pozicionin e mbetur vakant “Specialiste (pa grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit të Barnave Veterinare, Departamenti i Toksikologjisë”, në institucionin e ISUV (kategoria IV-a), me arsyetimin e nevojës së domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale të këtij pozicioni.

Duke mos qenë dakord me këtë lëvizje, kjo punonjëse e ka kundërshtuar atë pranë Drejtorit të ISUV dhe Departamentit të Administratës Publike, me pretendimin për kalim të

paligjshëm të saj në një pozicion tjetër të shërbimit civil, pa respektuar autoritetin dhe procedurën e parashikuar për raste të tilla dhe për më tepër, pa respektuar kategorinë e pagës, si dhe përgatitjen e saj shkencore.

Në vijim të hetimit administrativ konstatohet se, pas konsultimit verbal me Departamentin e Administratës Publike, drejtuesi i ISUV, me qëllim justifikimin e lëvizjes së mësipërme, pa anuluar aktin e mëparshëm dhe pa kthyer nëpunësen në pozicionin e saj të mëparshëm, ka nxjerrë aktin nr. 1226 prot., datë 18.12.2019, nëpërmjet të cilit ka njoftuar Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Departamentin e Administratës Publike, si dhe nëpunësen në fjalë, se për nevoja pune, nëpunësja ***** transferohet përkohësisht, për një periudhë 6-mujore, në pozicionin *“Specialist (pa grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit të Barnave Veterinare, Departamenti i Toksikologjisë”*.

Për sqarimin e kësaj çështje, hetimi administrativ u bazua tek praktika shkencore e dërguar nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të regjistruar pranë Komisionerit me nr.30/2 prot., datë 20.01.2020; aktet e dërguara nga Departamenti i Administratës Publike me nr. 30/5 prot., datë 24.01.2020, si dhe dokumentacioni i bashkëlidhur ankesës së paraqitur nga nëpunësja *****.

Nga shqyrtimi i materialeve të administruara rezultoi se shkak për këtë hetim administrativ, është bërë fakti që ankuesja është transferuar në një pozicion tjetër të shërbimit civil, (në fillim me emërtimin *“lëvizje paralele”* dhe më pas *“me transferim të përkohshëm”*) me akte të titullarit të institucionit, pa respektuar kërkesat e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe kushtet e Vendimit nr. 125, datë 17.02.20116, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*.

Konkretisht, akti nr. 135, datë 12.12.2019, për lëvizjen paralele të nëpunëses ***** , nga pozicioni *“Specialist (me grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve Shtazore, Departamenti i Mikrobiologjisë”*, (kategoria III-b) në pozicionin *“Specialist (pa grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit të Barnave Veterinare, Departamenti i Toksikologjisë”*, në institucionin e ISUV (kategoria IV-a), është një akt absolutisht i pavlefshëm, pasi, lëvizja paralele është një proces administrativ i cili kryhet duke respektuar rregullat procedurale që parashikon neni 25, i ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*.

Në këto dispozita përcaktohet se, lëvizja paralele e nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive është një procedurë konkurruese, që fillon me shpalljen e vendit vakant, dorëzimin e aplikimeve dhe dokumentacionit nga të interesuarit, etj., e vijon me kryerjen e procedurës administrative prej njësisë përgjegjëse, e cila ka në thelbin e saj shprehjen e vullnetit nga nëpunësi i interesuar. Mosrespektimi i kësaj procedure bën që akti nr. 135, datë 12.12.2019, për lëvizjen paralele të nëpunëses ***** , të jetë një akt absolutisht i pavlefshëm, i cili bazuar në pikën a/ii, të nenit 108, të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i*

RSH” duhet të konstatohet si i tillë nga vetë organi publik që e ka nxjerrë. Sipas nenit 111 të KPA, për të rregulluar pasojat, duhet të kthehet nëpunësja në pozicionin e saj të mëparshëm “Specialist (me grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve Shtazore, Departamenti i Mikrobiologjisë” (kategoria III-b).

Po kështu, lëvizja në detyrë në këtë rast, nuk mund të justifikohet me aktin e dytë të nxjerrë nga Drejtori i ISUV, me nr. 1226 prot., datë 18.12.2019, nëpërmjet së cilës njoftohet transferimi i përkohshëm për një periudhë 6-mujore, i nëpunëses *****, në pozicionin “Specialist (pa grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit të Barnave Veterinare, Departamenti i Toksikologjisë”. Kjo për faktin se procedura e transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil, është një veprim administrativ i cili rregullohet nga neni 48 “Transferimi i përkohshëm”, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kërkesat e Vendimit nr. 125, datë 17.02.20116, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Dispozitat e Kreut I, pikat 2-12, të vendimit nr. 125, datë 17.02.20116, të Këshillit të Ministrave, parashikojnë me hollësi kryerjen e disa veprimeve administrative të cilat konsistojnë në paraqitjen e një kërkesë nga ana e institucionit, ku tregohen arsyet e transferimit dhe evidentimi i faktit të ruajtjes së kategorisë së pozicionit, akt i cili vihet në zbatim vetëm pas miratimit nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, gjë që nuk rezulton të ketë ndodhur në këtë rast.

Në këto kushte, transferimi i përkohshëm i kryer me shkresën nr. 1226 dt. 18.12.2019, të titullarit të institucionit, përderisa nuk ka një akt për miratimin nga ana e DAP, konsiderohet se nuk është realizuar dhe nëpunësja *****, duhet të kthehet në pozicionin e saj të punës “Specialist (me grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve Shtazore, Departamenti i Mikrobiologjisë”.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenin 90, pika 1, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 16, pika 8 dhe nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) që, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, të organizojë dhe ndjekë procesin, nëpërmjet të cilit Drejtori i institucionit në fjalë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr.135, datë 12.12.2019, për lëvizje paralele të nëpunëses *****, nga pozicioni “Specialist në Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve Shtazore, Departamenti i Mikrobiologjisë” në pozicionin Specialiste (pa grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit të Barnave

*Veterinare, Departamenti i Toksikologjisë”, si akt absolutisht i pavlefshëm dhe në bazë të nenit 111, të Kodit të Procedurave Administrative, të rregullojë pasojat duke e kthyer nëpunësen ***** në pozicionin e mëparshëm të punës, “Specialist (me grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve Shtazore, Departamenti i Mikrobiologjisë”.*

2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e nëpunësit civil, që nuk ka kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin e rivendosjes së gjendjes së ligjshmërisë, duke përdorur mjetet ligjore, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha